



GRADITËSIA KOSOVARE / UTRAVAJA ADMINISTRATIVË		
Dokument me numër 09.02.2024		
Ng. led.	Nr. Br.	Shtojci / Prilog
02-355 / 02-0010284 / 24		
PODUJEVË - PODUJEVO		

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova



Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## Raport vjetor i punës së Zyrës për Marrëdhëniet me Publikun dhe Informim për vitin 2023

### Detyrat dhe përgjegjësitet e Zyrës për Marrëdhëniet me Publikun dhe Informim (ZMPI)

- Merr pjesë në takimet e drejtpërdrejta të Kryetarit të Komunës, brenda dhe jashtë Komunës;
- Përcjellë mbledhjet e Bordit të drejtoreve, të Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete dhe mbledhjet e Kuvendit të Komunës;
- Koordinon ndërlidhjen me shtypin, në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Kryetarit të Komunës, drejtoreve të drejtorive dhe zyrave të tjera;
- Koordinon zhvillimin dhe zbatimin e akteve komunale për komunikim me publikun;
- Ofron informacione për projktet komunale;
- Siguron transparencë dhe qasje publike për punën e drejtoreve të administratës komunale, të institucioneve arsimore dhe shëndetësore dhe të ndërmarrjeve publike lokale, duke u ofruar informata dhe dokumente qytetarëve dhe mediave;
- Informon publikun për vendimet që miraton Kuvendi, përmes njoftimeve në ueb faqen zyrtare të Komunës, dhe në rrjete sociale, si dhe përmes konferencave.
- Mban lidhje me shtypin lokal dhe mediat elektronike për çështjet në interes të qytetarëve

- Siguron informacione brenda Komunës dhe është në bashkëpunim të përhershëm me drejtorët e drejtorive dhe shërbyesit civilë të punësuar në drejtoritë e administratës; Shoqëron përfaqësuesit të mediave brenda Komunës dhe regjistrin deklaratat e zyrtarëve komunalë dhënë për media të ndryshme lokale dhe ato qendrore
- Kryen edhe punë të tjera të parapara me ligj, Statutin e Komunës së Podujevës dhe me rregulloret tjera.

Zyra për Marrëdhëniet me Publikun dhe Informim (ZMPI), përtej detyrave dhe përgjegjësive të lartcektina, në baza të rregullta merret edhe me forma të tjera të komunikimit siç është ajo përmes rrjeteve sociale.

Pra, për këtë qëllim stafi i ZMPI menaxhon edhe faqen e Komunës së Podujevës në facebook, ueb faqen e komunës në kategorinë e lajmeve, faqen e kryetarit të komunës në në facebook dhe Instagram, u kthen përgjigje të gjitha pyetjeve që vijnë nga mediat, organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarëve.

Po ashtu, kjo Zyre në bashkëpunim me zyrtarin për qasje në dokumente publike, koordinon punën dhe bashkëpunon për të kthyer përgjigje në secilën kërkesë që i adresohet Komunës së Podujevës, përmes kërkesës për qasje në dokumentet publike.

Në bashkëpunim me zyrtarët përgjegjës në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës, ZMPI, merr pjesë edhe në organizimin e vizitave në teren, ceremonive të ndryshme të përrurimit të projekteve të komunës për të cilat përgatit komunikata, dhe po të njëjtat u përcjell mediave.

Po ashtu, varësisht nga rëndësia e projekteve, disa prej tyre paraqiten edhe me video të cilat rcalizohen nga stafi i Zyres dhe nga kontrata e lidhur me një operator e cila po ashtu menaxhohet nga ZMPI.

ZMPI, bazuar në rregullativën ligjore, përcjell debatet publike të Kornizës Afatmesme Buxhetore, dëgjimet buxhetore dhe debatet 6 mujore të kryetarit me qytetarë të cilat parashihen të mbahen gjatë një viti kalendarik, përgatit procesverbalet përgatit komunikatën dhe së bashku me fotot e debateve i publikon në ueb faqen zyrtare dhe në rrjete sociale të komunës.

Për çështje me rëndësi për komunën ZMPI në bashkëpuniin me Kabinetin e Kryetarit organizon edhe konferanca për media, në të cilat ftohen mediat lokale dhe nacionale, dhe për të cilat postohet komunikata zyrtare nga ueb faqja e komunës.

Në vitin 2023 Komuna e Podujevës ka kontraktuar një kompani për transmetimin e debateve publike, mbledhjeve të kuvendit, transmetimin e ngjarjeve kulturore, kontratë kjo e cila menaxhohet nga Zyra e Informimit.

Në esencë, qëllimi i lidhjes së kësaj kontrate është që kuvendi, pra vendi ku përfaqësohen të gjithë qytetarët përnies partive politike, të transmetohet direkt që të kenë edhe qytetarët akses në përcjelljen e këtyre mbledhjeve. Po ashtu edhe debatet publike ku merr pjesë kryetari i Komunës, anëtarët e ekzekutivit dhe qytetarët të jenë publike dhe të dëgjohen edhe nga publiku, duke rritur kështu komunikimin dhe transparencën e komunës.

Po ashtu, si Zyre përcjellim secilin takim të Komitetit për Politikë dhe Finance (KPF) Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), Komitetit për Komunitete (KK) Shtabit Lokal Emergjent dhe Shtabeve tjera që funksionojnë përgjatë vitit, të cilat gjithmonë pasohen me komunikata zyrtare në faqen e komunës.

Zyra e informimit gjatë gjithë angazhimit të saj, përveç që zbaton detyrat brenda përgjegjësisë dhe fushëveprimit që ka, angazhohet edhe në secilin aspekt tjeter të komunikimit me qëllimin e vetëm që qytetarët, mediat dhe institucionet që monitorojnë punën e komunës të jenë të informuara në kohë për të gjitha zhvillimet që ndodhin brenda administratës komunale.

Për këtë qëllim është publikuar numri i zyres dhe email adressa [infopodujeva@rks-gov.net](mailto:infopodujeva@rks-gov.net), në të cilat organizata të ndryshme, media dhe qytetarë bëjnë thirrje dhe dërgojnë emala në të cilat përgjigjemi në kohë sa më të shpejtë.

Zyrtarët e ZMPI gjatë këtij viti në vazhdimësi kanë ndjekur trajnime, me qëllim të rritjes së kapaciteteve dhe njojurive të reja, sidomos në fushën e transparencës me qëllim që ato të përdoren e praktikohen përmirësimin e mëtejmë të raportit të komunikimit komunë — qytetarë.

Trajtim të veçantë gjithmonë u kushtohet njoftimeve publike, të cilat përveç që shpëndahen në ueb faqen zyrtare, ato i vendosim edhe në tabela në qytet dhe në bashkësitë lokale, Orllan, Lluzhan dhe Kërpimeh me qëllim që njoftimet të arrijnë te secili qytetarë.

Për të qenë edhe më korrekt përmes koordinatorit të fshatrave edhe përmes telefonit njoftohen përfaqësuesit e fshatrave, gjithmonë për të marrë pjesë në diskutimet publike.

Po ashtu, edhe thirrjet e ndryshme për aplikime, subvencione dhe njoftimet tjera nga komuna publikohen dhe shpëndahan.

Për secilin aktivitet të Kryetarit të Komunës, kuvendit, ekzekutivit dhe të tjerë, përmes faqës ne facebook, ueb dhe me email, paraprakisht njoftohen mediat e shkruara dhe qytetarët.

Në forme tabelare janë paraqitur lajmet, njoftimet, ftesat-thirrjet dhe konkurset e postuara në faqen zyrtare të komumes.

<b>Muaj</b>	<b>Lajme</b>	<b>Njoftime</b>	<b>Ftesa-Thirrje</b>	<b>Konkurse</b>
<b>Janar</b>	34	17	1	-
<b>Shkurt</b>	30	9	2	1
<b>Mars</b>	42	13	8	-
<b>Prill</b>	25	7	6	-
<b>Maj</b>	36	32	2	-
<b>Qershor</b>	56	27	4	-
<b>Korrik</b>	49	27	-	1
<b>Gusht</b>	45	37	-	1
<b>Shtator</b>	23	13	-	-
<b>Tetor</b>	45	14	4	-
<b>Nentor</b>	40	14	1	-
<b>Dhjetor</b>	52	20	1	1
<b>Totali</b>	<b>477</b>	<b>230</b>	<b>29</b>	<b>4</b>

Ndërsa, për të parë formën e plotë të postimit të lajmeve në ueb faqen zyrtare, klikoni vegezen;

<https://kk.rks-gov.net/podujeve/podujeve-2/lajmet/>

Në kuadër të zyrës për informim janë bërë edhe të gjitha njoftimet e dokumenteve të inicuara nga drejtoritë e ndryshme për konsultim publik, njoftime për debatin publik, si dhe përgatitja e raportit të mbajtjes së konsultimeve publike për vitin 2023, si dhe plani i konsultimeve publike për vitin 2024.

Këto plane dhe raporte janë të publikuara ne ueb faqen zyrtare të komunës së Podujevës dhe ne platformën qëndrore Ekonsultimet, për më shumë klikoni vegëzat;

<https://kk.rks-gov.net/podujeve/debat-publik-me-qytetare/>

[Konsultat publike | Konsultimet publike \(rks-gov.net\)](#)

Në kuadër të zyrës së informimit, ne intervale të rregullta kohore bëhet, publikimi në uebfaqe i vendimeve të kryetarit, publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Komunitete, KPF-së dhe KK-së, publikimi i lajmeve, njoftimeve për aktivitetet e kryetarit dhe drejtoreve komunal dhe përgaditja e raporteve javore të ZMPI, për kryetarin.

Gjithashtu faqja e kryetarit të komunës në rrjetin social facebook dhe instagram mirëmbahet nga ZMPI, e cila përgjatë vitit 2023 ka realizuar mbi 400 postime.

**04.01.2024, Podujevë**

**Zyra për Marrëdhëniet me Publikun dhe Informim**